**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria –Vlada-Government*
*Ministria e Punëve te Brendshme / Ministarstvo Unutraśnjih Poslova / Ministry Of Internal Affairs*

# STRATEGJIA SHTETËRORE KUNDËR NARKOTIKËVE DHE PLANI I VEPRIMIT 2018 – 2022

**Gusht 2018**

## Përmbajtja


**1 Hyrje ........ 6**

1.1 Qëllimi ........ 7

1.2 Vizioni ........ 7

**2 Metodologjia ........ 7**

**3 Parimet e Përgjithshme ........ 8**

**4 Situata aktuale ........ 8**

**5 Korniza ligjore dhe mekanizmat institucional ........ 10**

5.1 Korniza ligjore ........ 11

5.2 Mekanizmi institucional ........ 11

**6 Objektivat e Strategjisë kundër Narkotikeve ........ 15**

**7 Zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi i Strategjisë ........ 17**

7.1 Roli i sistemit të monitorimit dhe vlerësimit ........ **Error! Bookmark not defined.**17

**8 Plani i Veprimit 2018-2020 ........ 18**

# Lista e shkurtesave

ZKM - Zyra e Kryeministrit
MPB - Ministria e Punëve të Brendshme
KN - Koordinatori Nacional
PK - Policia e Kosovës
MF - Ministria e Financave
MD - Ministria e Drejtësisë
MTI - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MBPZHR - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MPMS - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
AKI - Agjencia e Kosovës për Inteligjencë
MASHT - Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MKRS - Ministria e Kulturës, Rinisë, dhe Sportit
MSH - Ministria e Shëndetësisë
IF - Inspektorati Farmaceutik
ISH - Inspektorati Shëndetësor
AKPPM - Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale
AKF - Agjencia e Kosovës për Forenzikë
MPJ - Ministria e Punëve të Jashtme
MIE - Ministria e Integrimit Evropian
NJIF - Njësisa e Inteligjencës Financiare
DK - Dogana e Kosovës
KGJK - Këshilli Gjyqësor i Kosovës
AD - Akademia e Drejtësisë
IGJK - Instituti Gjyqësor i Kosovës
KP - Këshilli Prokurorial
SHK - Shërbimi Korrektues
MMPH - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
SHSK - Shërbimi Sprovues i Kosovës
QKMK - Qendra Kombëtare për Menaxhim Kufitar
DSHB - Departamenti Shëndetësor i Burgjeve
AKSP - Akademia Kosovare për Siguri Publike
UNDP - Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
OSBE - Organizata për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë
ICITAP - Programi ndërkombëtar i asistencës në trajnim për hetimet penale
KFOR - Forcat Ushtarake të Sigurisë Ndërkombëtare në Kosovë
KE - Këshilli i Evropës
IEK - Informim, Edukim, Komunikim
OJQ - Organizata Joqeveritare
DIFID - Departamenti për Zhvillim Ndërkombëtar i Britanisë së Madhe
PEER TO PEER - Të njëjtit për të njëjtë
OUTREACH - Aktivitetet që zhvillohen në terren jashtë selisë së Organizatës apo Institucionit
BQK - Banka Qendrore e Kosovës
ISH - Institucionet Shëndetësore

SECI - Center Iniciativa e Evropës Juglindore për Kooperim
UNDOC - Zyra e Kombeve të Bashkuara për Droga dhe kriminalitet
IBZ - Instituti i Bazelit Zvicër
EMCDDA - Qendra Evropiane për Monitorimin e Përdorimit të Drogave
KE - Komisioni Evropian

## Përmbledhje ekzekutive

Strategjia Shtetërore Kundër Narkotikeve është dokument i cili prezanton situatën e përgjithshme, mekanizmat institucional, dobësitë e tanishme, parimet themelore në luftimin kundër narkotikeve së bashku me disa faktorë kryesor për arritje të suksesit dhe më në fund do t'i përcaktojë synimet dhe mënyrat e mundshme për arritjen e tyre. Strategjia Shtetërore Kundër Narkotikeve e Republikës së Kosovës, për periudhën 2018-2022 është vazhdimësi e strategjisë paraprake dhe mbështetet në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, legjislacionin e aplikueshëm në Republikën e Kosovës, si dhe instrumentet ligjore ndërkombëtare dhe praktikat më të mira ndërkombëtare në fushën e parandalimit dhe luftimit të krimit të narkotikeve. Deri sa strategjia paraprake ka pasur si qëllim kryesor themelimin-ndërtimin e mekanizmit institucional, kjo strategji ka për qëllim të ngritë efikasitetin dhe efektivitetin e institucioneve në këtë fushë. Ky dokument është i strukturuar në mënyrë të tillë që të identifikoj qartë objektivat dhe aktivitetet që duhet të përmbushën, në mënyrë që i gjithë mekanizimi institucional të vihet në funksion të parandalimit dhe luftimit me sukses të narkotikeve, si dhe duke qenë partner serioz me vendet tjera në përpjekjet ndërkombëtare në luftë kundër kësaj dukurie përmes bashkëpunimit ndërkombëtare. Shumëllojshmëria e veprimeve të grupeve të ndryshme kriminale dhe lokacioni apo territori ku ato veprojnë u ofron mundësi që në mënyrë më efektive t'i adaptohen situatave të ndryshueshme në vend, duke i shfrytëzuar dobësitë e bashkëpunimit nderinstitucional dhe ndërkombëtarë të organeve për zbatim të ligjit. Në këtë kontekst nuk ka asnjë shtet i cili është tërësisht i sigurt dhe i mbrojtur nga keqperdorimi i narkotikeve, prandaj përjashtim nga kjo nuk bën as Republika e Kosovës. Strategjia shtetërore Kundër Narkotikeve ka për qëllim që të rris akoma më shumë përpjekjet e Institucioneve të Kosovës në fushën e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar si dhe te ndihmojë në zhvillimin dhe zbatimin e politikave duke forcuar kapacitetet institucionale kundër këtij lloji të krimit. Politikat për kontrollimin dhe parandalimin e narkotikëve duhet të bazohen në të kuptuarit më të thellë se çka paraqesin sipas standardeve ndërkombëtare, narkotiket, cila është fushëveprimtaria, metodat e operimeve dhe trendët e krimit në një shtet apo regjion të caktuar. Qëllimi i strategjisë është që me përdorim sa më racional të burimeve materiale, financiare dhe njerëzore të arrihet ngritja e mekanizmit institucional, bashkëpunimit dhe koordinimit në luftë kundër narkotikeve. Republika e Kosovës bën përpjekje të vazhdueshme për përmirësimin e situatës në fushën e sundimit të ligjit dhe të merret në mënyrë efikase me luftimin e narkotikeve i cili është si kusht për progres drejt rrugës evropiane, duke zbatuar një politikë të besueshme dhe reale në këtë aspekt.

Qëllimi i kësaj strategjie është zhvillimi i mëtejmë i politikave për marrjen e përgjegjësive për mbrojtjen e individit dhe shoqërisë, dhe problemet që janë pasojë e narkotikeve.

Hartimi i këtij dokumenti orientohet në përcaktimin e objektivave, përgatitjen e kuadrit si dhe veprimeve të përbashkëta të të gjitha institucioneve që do të ndërmarrin në pesë vjetet e ardhshme 2018-2022.

# 1. Hyrje

Republika e Kosovës gjegjësisht Qeveria duke qenë e vetëdijshme për dukurinë e narkotikeve si një dukuri ndërkombëtare e cila në mënyrë direkte dhe indirekte paraqet rrezik për vendin tonë harton dhe miraton Strategjinë e trete Shtetërore kundër Narkotikeve dhe Planin e Veprimit 2018-2022

Përmes këtij dokumenti, Qeveria e Kosovës obligon institucionet përgjegjëse të vendit për të ndërmarrë veprime konkrete në fushën e parandalimit dhe luftimit të kësaj dukurie negative dhe të rrezikshme për vendin tonë dhe njëkohësisht nxit dhe përkrah OJQ-të për të dhënë kontributin e tyre. Duke qenë se Kosova si pozitë gjeostrategjike gjendet në pjesën qendrore të Gadishullit Ballkanik, e ndërlidhur me shtetet e rajonit, vazhdimisht ka tendenca të atakimit nga kjo dukuri qoftë në përdorimin e drogave po ashtu në trafikimin brenda apo përmes territorit tonë.

Qeveria e Republikës së Kosovës, është duke bërë përpjekje që të përmirësojë situatën aktuale përmes parandalimit dhe luftimit të kësaj dukurie me qëllim të progresit drejt rrugës së integrimeve euro-atlantike, njëkohësisht shpreh vullnetin për të bashkëpunuar me të gjitha shtetet dhe mekanizmat tjerë ndërkombëtar për të minimizuar pasojat nga narkotiket.

Veprimet të cilat do të ndërmerren nga institucionet vendore të parapara me këtë strategji janë të orientuara dhe të ndërlidhura në reduktimin e kërkesës dhe ofertës me qëllim minimizimin te dëmeve nga dukuria e narkotikeve. Këto veprime sipas kësaj strategjie dhe planit të veprimit obligojnë institucionet shtetërore për marrjen e përgjegjësive dhe detyrave sipas fushave përkatëse, te cilat janë të koordinuara nga MPB-ja , si përgjegjëse e hartimit dhe zbatimit të kësaj strategjie.
Në kuptimin gjithëpërfshirës, narkotiket paraqesin materie psiko-aktive, të cilat po qe se përdoren nga ana e personit kanë aftësi që të ndryshojnë dhe dëmtojnë seriozisht integritetin psiko-fizik të personit i cili i përdor, gjegjësisht i keqpërdorë ato.

Keqpërdorimi me narkotik është problem i madh shoqëror dhe shëndetësor në mbarë botën, ngase pasojat që dalin nga efektet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta nga kjo dukuri janë shumëfish të dëmshme për vetë personin, familjen dhe shoqërinë në tërësi si dhe ndikon në rrezikimin e sigurisë shtetërore.
Kjo strategji është e strukturuar në mënyrë të tillë që të identifikoj qartë qëllimet dhe objektivat për të parandaluar dhe luftuar trafikimin e narkotikeve dhe substancave tjera psikoaktive.

### 1.1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj strategjie është që me përdorim sa më racional të burimeve materiale, financiare dhe njerëzore të zhvillojë politika për marrjen e përgjegjësive për mbrojtjen e individit dhe shoqërisë nga problemet që janë pasojë e keqpërdorimit të narkotikëve.

### 1.2 Vizioni

Vizioni i kësaj strategjie është krijimi i një ambienti të sigurt për një shoqëri të shëndetshme duke minimizuar dëmet, pamundësuar, trafikimin, përdorimin, kultivimin e narkotikëve dhe substancave tjera psikoaktive dhe prekusorëve në territorin e Republikës së Kosovës.

## 2 Metodologjia

Strategjia Shtetërore kundër Narkotikeve dhe Plani i Veprimit 2018-2022 është hartuar në mbështetje të Planit Vjetor të Punës së Qeverisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme për vitin 2018 dhe Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit 2017-2021.

Strategjia është në harmoni të plotë me Udhëzimi Administrativ nr. 02/2012 për procedurat, kriteret dhe metodologjinë e përgatitjes dhe miratimit të dokumenteve strategjike dhe planeve për zbatimin e tyre si dhe legjislacionin përkatës në fuqi.
Grupi i Punës për hartimin e Strategjisë është formuar nga ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme me Vendimin Nr. 249/2017 të datës 01.09.2017 ku janë të përfshira të gjitha institucionet përkatëse shtetërore, shoqëria civile dhe partnerët ndërkombëtarë. Drafti i strategjisë është hartuar me përfshirjen e të gjithë akterëve të grupit punues ndërsa më qëllim të finalizimit të draftit është mbajtur punëtoria në Shqipëri prej 26.10.2017deri me 29.10.2017 e mbështetur nga Zyra e BE-së ne Kosovë.

Strategjia është hartuar duke u bazuar në vlerësimet e brendshme si: analizat vjetore të zbatimit të strategjisë së mëparshme për vitet 2012-2017, Vlerësimit të Kërcënimit nga Krimet e Rënda dhe Krimi i Organizuar (SOCTA), raportet analitike dhe vlerësuese të Policisë së Kosovës dhe Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, si dhe dokumentet tjera përkatëse. Në anën tjetër, vlerësimet e jashtme përfshijnë raportet për Kosovën nga Departamenti Amerikan i Shtetit, EUROPOL-it për situatën e Krimit të Organizuar dhe trendit në BE, Komisionit Evropian, OJQ-të si dhe dokumentet tjera.

## 3. Parimet e Përgjithshme

Struktura dhe përmbajtja e këtij dokumenti bazohet në këto parime:

**Parimi i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë** - veprimet e ndërmarra për të parandaluar dhe luftuar narkotikët bazohen në dispozitat e parapara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, legjislacionit në fuqi dhe marrëveshjet ndërkombëtare.

**Parimi i qasjes gjithëpërfshirëse shtetërore –** parandalimi dhe luftimi efektiv i kërcënimeve nga Narkotikët arrihet përmes përfshirjes dhe bashkëpunimit të ngushtë në mes të institucioneve qeveritare, publike, shoqërisë civile, sektorit privat dhe organizatave ndërkombëtare.

**Parimi i lirive dhe të drejtave të njeriut –** nënkupton garantimin e lirive dhe të drejtave të gjithë individëve, gjatë të gjitha fazave të angazhimit të institucioneve në parandalimin dhe luftimin e Narkotikëve.

**Parimi i konfidencialitetit** – institucionet me përgjegjësi në parandalimin dhe luftimin e narkotikëve duhet të sigurojnë ruajtjen e konfidencialitetit të informatave të shkruara dhe jo të shkruara të shkëmbyera gjatë procesit të hetimeve dhe diskutimeve.

**Parimi i bashkëpunimit** – Qeveria e Republikës së Kosovës është e përkushtuar në respektimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve midis institucioneve vendore dhe bashkëpunimin ndërkombëtarë në luftën kundër narkotikëve.

**Parimi i besueshmërisë** – Institucionet përgjegjëse për parandalimin dhe luftimin e narkotikëve duhet të kujdesën për ndërtimin e besimit në ruajtjen e integritetit të hetimeve, të dhënave dhe informacioneve nga keqpërdorimi nga ata që kanë qasje në to.

**Parimi i proporcionalitetit** – nënkupton ushtrimin e autoritetit të institucioneve që merren në parandalimin dhe luftimin e narkotikëve, vetëm atëherë kur është e domosdoshme dhe vetëm deri në nivelin që nevojitet për të arritur objektivat legjitime, me mjete dhe metoda të përshtatshme, kohë sa më të shkurtër të mundshme.

**Parimi i bashkëpunimit ndërkombëtar** – parandalimi dhe luftimi efikas i narkotikëve arrihet përmes bashkëpunimit ndërkombëtar me shtete, organizata dhe iniciativa. Përmes bashkëpunimit, Republika e Kosovës do të luajë rol qenësor në luftën globale kundër narkotikëve.

# 4. Situata Aktuale

Prodhimi, trafikimi dhe përdorimi i paligjshme i narkotikëve vazhdon të jetë problem mjaft shqetësues për të ardhmen e rinisë sonë dhe popullatës në përgjithësi në Kosovë, si në aspektin shëndetësor, ekonomik, social të sigurisë etj.
Lufta kundër narkotikëve, mbetet një ndër prioritetet kryesore të institucioneve shtetërore të sigurisë së vendit tonë, në kuadër të veprimeve konkrete kundër krimit të organizuar.
Vendi ynë, për shkak të pozitës strategjike që ka, vazhdimisht është përdorur nga kriminelët si një vend transit dhe një ndër rrugët e trafikimit të drogës nga lindja në perëndim, përmes vendeve fqinje. Pas arritjes së lëndëve narkotike në Kosovë, një pjesë e vogël mbetet këtu, ndërsa pjesa tjetër transportohet për në vendet perëndimore.
Substancat narkotike futen në Kosovë, nëpër kufijtë e të gjitha shteteve të rajonit dhe anasjelltas, pastaj edhe nga hyrje daljet ilegale ndërmjet shteteve.
Transportimi i substancave narkotike në Republikën e Kosovë dhe jashtë Kosovës, përgjithësisht bëhet me automjete të ndryshme transportuese, si: vetura, furgone, kamionë, autobusë etj. Janë evidentuar raste kur automjete të ndryshme, modifikohen dhe brenda tyre rregullohen bunkerë të fshehtë për vendosje të narkotikëve. Transportimi i narkotikëve bëhet edhe duke e fshehur në pjesë të brendshme të mobileve (bunkerë).
Autobusë të agjencive të ndryshme turistike, të cilat në aktivitetin e tyre kryesor e kanë transportimin e udhëtarëve, në mënyrë të fshehtë transportojnë edhe substanca narkotike, për në Kosovë ose jashtë Kosovës në shtetet e rajonit.
Në kohën e tanishme, një person qoftë konsumues apo trafikant, mund të vijë deri te droga sepse ajo mund të gjendet në sasi të caktuara, në rrugë, në shkollë dhe afër shkollave, lokale të natës, kioskë, shitore, në shtëpi, institucione zyrtare (qendra korrektuese) etj.
Me rritje të kërkesave për narkotikë, pashmangshëm do të rritet edhe numri i veprave penale si: mashtrime, vjedhje, grabitje, sulme fizike dhe vepra tjera të rënda, ku si të dyshuar përveç tjerëve do të jenë edhe ata të rinj të cilët nuk kanë mjete financiare për blerjen e narkotikëve dhe mund të bëhen agresiv deri sa nuk e sigurojnë narkotikë.
Sa i përket numrit të personave që e përdorin narkotikë, në Kosovë, ende nuk është kryer ndonjë anketim i popullatës së përgjithshme mbi përdorimin e narkotikëve apo regjistrim i përdoruesve të narkotikëve, kështu që nuk mund të caktohet ndonjë shifër e saktë e numrit të konsumuesve të narkotikëve pa pasur hulumtime serioze dhe gjithëpërfshirëse.
Konsumuesit e substancave narkotike janë nga mosha të ndryshme, megjithatë dominojnë të rinjtë, nxënësit e shkollave të mesme dhe ata të shkollave fillore(*Referenca:* Vlerësimi Strategjik i Policisë së Kosovës -2016, fq 20).
Narkotikët me të frekuentuara aktualisht në Republikën e Kosovës janë: marihuana, kokaina dhe heroina.
Bazuar në statistikat vendore, viteve të fundit, konsumimi i heroinës ka pësuar rënie, ndërsa është rritur numri i konsumuesve të Marihuanës. (*Referenca*:Vlerësimi Strategjik i Policisë së Kosovës -2016, fq. 21 dhe 22).
Deri te kjo gjendje ka ardhur për arsye se marihuana gjendet më lehtë në treg dhe çmimi i saj është më i lirë krahasuar me substancat tjera.
Në kuadër të luftës kundër grupeve kriminale të trafikimit të narkotikëve në Kosovë dhe jashtë vendit tonë, Policia e Kosovës, ka pasur bashkëpunime të shumta me institucione ndërkombëtare të sigurisë me qëllim të shkëmbimit të informatave dhe identifikimit të rrjeteve kriminale që veprojnë jashtë Kosovës.

Përmes fushatave të vazhdueshme nga Institucionet vendore dhe nga OJQ-të OJQ, shume të rinj tashmë janë pajisur me informata se përdorimi i substancave narkotike dhe keqpërdorimi i saj janë të kundërligjshme por edhe të rrezikshme për vetë individin dhe shoqerine.
Si rezultat i këtyre masave të ndërmarra për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me narkotik, është arritur që në një formë të anashkalohet vendi ynë nga trafikuesit e lëndëve narkotike, të cilët janë detyruar që të gjejnë rrugë tjera alternative më lehtë të depërtueshme për trafikim.

# 5. Korniza ligjore dhe mekanizmat institucional

## 5.1 Korniza ligjore

Në fushën e narkotikëve, Republika e Kosovës ka në zbatim një bazë të gjerë ligjore, e cila përfshin por nuk kufizohet në:

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës
2. Kodi Penal i Republikës së Kosovës
3. Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës
4. Ligji nr. 02/L-128 për Barnat Narkotike, substanca Psikotrope dhe Prekursorë
5. Ligji për agjencinë e Kosovës për inteligjencë
6. Ligji nr.03/L-199- Gjykatat
7. Ligji nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit
8. Ligji nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës
9. Ligji nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës
10. Ligji nr. 03/L-052 për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës
11. Ligji nr 05/ L-103 per ndryshimin dhe plotësimin e Ligjeve qe ndërlidhen me mandatin e misionit të bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Republikën e Kosovës.
12. Ligji nr. 04/L-076 për Policinë
13. Ligji nr. 04/-L-015 për mbrojtjen e Dëshmitarëve
14. Ligji nr. 04/L-043 për mbrojtjen e Informatorëve
15. Kodi Drejtësisë për të Mitur nr.03/L-193
16. Kodi doganor dhe i akcizave
17. Ligji nr. 03/L-191 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale
18. Ligji nr. 03/ L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare
19. Ligji nr. 03/L-137 për Departamentin e Mjekësisë Ligjore.
20. Ligji nr. 03/L-142 për Rendin dhe Qetësinë Publike
21. Ligji nr. 03/ L-097 për Masat Antidamping dhe Masat Kundërbalancuese
22. Ligji nr. 03/ L-187 për Mjekësinë Ligjore
23. Ligji nr. 03/L-196 për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit
24. Ligji nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës
25. Ligji nr. 04/L-030 për Përgjegjësinë e Personave Juridik për Vepra Penale
26. Ligji nr. 04/l-31 për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale
27. Ligji nr. 04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës
28. Ligji nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare
29. Ligji nr. 04/L-078 për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve

30. Ligji nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror dhe plotësim ndryshimi i këtij ligji Nr. 04/L-2014 për kontrollin e kufirit shtetëror
31. Ligji nr. 04/L-216 për Bashkëpunim Ndërmjet Autoriteteve të përfshira në MIK
31. Ligji nr. 04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas
32. Ligji nr. 04/L-093 për Bankat Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare
Jobankare
33. Ligji nr. 02/L-50 për Kujdesin Shëndetësor Emergjent
34. Ligji nr. 02/L-38 për Inspektoratin Shëndetësor
35. Ligji nr. 2004/50 për Veprimtarinë Private në Shëndetësi
36. Ligji për mbrojtjen sociale
37. Ligji nr. 02/L-57 për Institucionet e Kulturës
38. Ligji nr. 2004/38 për të Drejtat e përgjegjësitë e qytetarëve në sistemin shëndetësor
39. Ligji nr. 04/L-125 për Shëndetësi
40. Ligji për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse
41. Ligji nr. 03/L-124 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shëndetësi
42. Ligji nr. 02/L-76 për Shëndetin Riprodhues
43. Ligji nr. 02/L-101 për Transfuzionin e Gjakut, Kontrollin e Gjakut dhe Produkteve të tij
44. Ligji Nr. 04/L-064 për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë
45. Ligji nr 05/ L-025 për Shendetin Mendor
46. Ligji nr. 04/-L-015 për Mbrojtjen e Dëshmitarëve
47. Ligji nr. 04/L-060 për Mbeturinat
48. Ligji nr. 2004/32 Për mbrojtje nga dhuna ne familje
50. Ligji 04/L-218 për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit.

## 5.2 . Mekanizmi institucional

Mekanizmi institucional nënkupton të gjithë mekanizmat të cilët kanë rol dhe rëndësi në luftën kundër narkotikëve në Kosovë.

Mekanizmat institucional për hartimin dhe zbatimin e politikave shtetërore në fushën kundër narkotikëve janë por nuk kufizohen në institucione:

**Ministria e Punëve të Brendshme**
MPB është institucioni përgjegjës qeveritar që udhëheq në hartimin dhe monitorimin e politikave dhe legjislacionit në fushën e sigurisë së përgjithshme dhe narkotikëve. Përmes mekanizmave dhe agjencive të saj, MPB ndërmerr aktivitetet në parandalimin, mbrojtjen, ndjekjen dhe reagimin ndaj të gjitha aktiviteteve kundër narkotikëve.

**Koordinatori Nacional kundër Narkotikëve**
Koordinatori Nacional kundër Narkotikeve është Ministri i Punëve të Brendshme, ose personi i autorizuar nga ai, i cili është përgjegjës të bashkërendojë, udhëzojë, monitorojë dhe të raportojë për zbatimin e politikave, aktiviteteve dhe veprimeve në lidhje me Strategjinë kundër narkotikëve.

**Sekretariati i Strategjive**

Sekretariati i Strategjive ne MPB ka për detyrë të monitoroj në baza të rregullta zbatimin e strategjisë duke mbledhur dhe analizuar të dhëna rreth zbatimit të aktiviteteve të planit të veprimit, si dhe hartuar raportet periodike dhe vlerësuese për Koordinatorin Nacional. Përveç këtyre, Sekretariati do të ndihmoj Koordinatorin Nacional për koordinim e strategjisë dhe komunikimin me palët e interesit.

**Policia e Kosovës**

Si agjenci e zbatimin e ligjit në kuadër të MPB-së, PK ka përgjegjësinë kryesore në luftimin e narkotikëve , përmes Drejtorisë për hetimin e trafikimit me narkotike dhe strukturave tjera mbështetëse në kuadër të Policisë së Kosovës.

**Agjencia e Kosovës për Forenzikë**

Si agjencia për zbatimin e ligjit në kuadër të MPB-së, AKF ka përgjegjësi në kryerjen e ekspertizave forenzike profesionale dhe sipas standardeve ndërkombëtare si dhe në menaxhimin databazave forenzike.

**Agjencia e Menaxhimit Emergjent**

Si agjenci në kuadër të MPB-së, AME ka përgjegjësi  në zhvillimin e të gjitha masave për tu përgatitur, mbrojtur, reaguar, dhe rimëkëmbur nga të gjitha rreziqet e mundshme, qofshin ato natyrore apo të shkaktuara nga faktori njeri.

**Agjencia e Kosovës për Inteligjencë**

AKI është agjenci për siguri dhe inteligjencë e cila mbledh, analizon dhe shpërndan produkte inteligjente në mënyrë të shpejtë, të ligjshme dhe të përgjegjshme tek Presidenti, Kryeministri dhe Institucionet tjera kompetente.

**Këshilli Gjyqësor i Kosovës**

KGJK është institucion i pavarur në kryerjen e funksioneve të veta me qëllim të sigurimit të një sistemi të drejtësisë të pavarur, të drejtë, apolitik, të qasshëm, profesional dhe të paanshëm i cili pasqyron natyrën shumë etnike të Republikës së Kosovës dhe zbaton Kushtetutën si dhe parimet e pranuara ndërkombëtarisht për të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore, me qëllim që sistemi gjyqësorë të jetë sa më efikas në luftë kundër terrorizmit. KGJK siguron pavarësinë dhe paanësinë e sistemit gjyqësor.

**Pushteti Gjyqësor**

Pushteti Gjyqësor në Republikën e Kosovës ushtrohet nga Gjykatat të cilat janë të themeluara në përputhje me Kushtetutën dhe Ligjin përkatës, përkatësisht nga Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit dhe Supreme, kurse gjyqtarët gjatë ushtrimit të funksionit dhe marrjes së vendimeve janë të pavarur, të paanshëm, pa ndikuar në çfarëdo mënyre nga asnjë person fizik apo juridik përfshirë edhe organet publike.

**Këshilli Prokurorial i Kosovës**

Këshilli është një institucion i pavarur në ushtrimin e funksioneve të veta me qëllim të sigurimit të një sistemi prokurorial të pavarur, profesional dhe të paanshëm që pasqyron natyrën shumetnike të Republikës së Kosovës dhe parimet e pranuara ndërkombëtarisht të barazisë gjinore.

**Prokuroria e Shtetit**
Është institucion i pavarur, me autoritet dhe me përgjegjësi për ndjekjen penale të personave të akuzuar për ndonjë vepër penale ose për ndonjë vepër tjetër, sikurse është rregulluar me ligj. Prokuroria Speciale ka kompetencë të veçantë që të hetojë dhe ndjek penalisht krimet sipas nenit 5 te ligjit nr. 03/L-052, edhe të atyre në formë të tentimit, dhe formave te ndryshme të bashkëpunimit në krim, duke përfshirë kryerjen e akteve qe lidhen me narkotikët.

**Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës**
Sekretariati, si pjesë përbërëse e Këshillit të Sigurisë së Kosovës bën përgatitjen e raporteve periodike dhe analizave për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe Këshillin e Sigurisë së Kosovës që kanë të bëjnë me çështjet politike të sigurisë. Sekretariati i KSK-se bënë koordinimin e hartimit të strategjisë nacionale të sigurisë dhe politikave të sigurisë në Kosovë, përfshirë edhe ndërtimin e kapaciteteve, instrumentet e politikave dhe hulumtimit.

**Ministria e Drejtësisë**
Ministria e Drejtësisë zhvillon politikën brenda fushës së saj të përgjegjësisë, mundëson përgatitjen dhe zbatimin e legjislacionit në fushën e drejtësisë; ofron ndihmë juridike ndërkombëtare; Ofron mbështetje me ekspertë në përgatitjen e marrëveshjeve të Qeverisë në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar, Ruan dhe administron pasurinë e sekuestruar ose të konfiskuar në bashkëpunim me prokurorinë, gjykatën, apo organet tjera kompetente, në pajtim me ligjin në fuqi si dhe duke vënë prioritet bashkëpunimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve ne përmbushjen e obligimeve Strategjike të Strategjisë Shtetërorë Kundër Narkotikeve 2018-2022.

**Shërbimi Korrektues i Kosovës**
Në bashkëpunim me partneret e tjerë të drejtësisë dhe Ministine e Shëndetësisë synon trajtimin human të burgosurve përmes programeve te posaçme me qellim risocializimin dhe përgatitjen e tyre për jetë dhe sjellje të përgjegjshme për ri integrimin në shoqëri duke i respektuar të drejtat themelore të burgosurve pa diskriminim. Zbatimi i sanksioneve penale, po ashtu shërben për mbrojtjen e shoqërisë duke parandaluar kryerjen e veprave të tjera penale dhe duke përmbajtur të tjerët nga kryerja e veprave penale.

**Shërbimi Sprovues i Kosovës**
SHSK është përgjegjës për Ekzekutimin e masave dhe dënimeve alternative, mbikëqyrjen, risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin e të gjithë personave që kanë kryer vepra penale të ndëshkueshme sipas ligjeve të aplikueshme në Republikën e Kosovës. Po ashtu SHSK, ka për mandat edhe riintegrimin dhe rehabilitimin e personave të liruar me kusht nga burgu.

**Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës**
MFSK përmes mekanizmave të saj ndihmon institucionet vendore në parandalimin e terrorizmit, ndërsa me njësitet e saj merr pjesë aktive në mbrojtje dhe reagim ndaj sulmeve të mundshëm terroriste.

**Ministria e Financave**
MF do të ketë rol aktiv dhe bashkëpunues me të gjitha institucionet e ndikuar nga Plani i Veprimit për zbatimin e Strategjisë kundër narkotikëve, duke u përkujdesur që aktivitetet dhe objektivat e parapara të realizohen brenda ndarjeve të rregullta buxhetore.

**Dogana e Kosovës**
Si agjenci në kuadër të Ministrisë së Financave duke ushtruar funksionin e vet të kontrollit të mallrave dhe personave në pikat e kalimit kufitar dhe brenda territorit të Kosovës kontribuon në rritjen e sigurisë, luftimin e krimit kufitar dhe parandalimin e trafikimit me narkotik.

**QKMK Qendra Kombëtare për Menaxhim Kufitar**
Nënkupton mekanizmin e vendosur në MPB, që ka për funksion bashkërendimin e aktiviteteve dhe operacioneve që dalin nga kërkesat e autoriteteve të përfshira në MIK dhe autoriteteve, agjencive tjera, duke ofruar mbështetje, lehtësuar shkëmbimin e informatave, kontrollin dhe monitorim me TVQM dhe pajisje tjera pranë saj, rritjen e integrimit në mes të autoriteteve të përfshira në fushën e menaxhimit të kufirit shtetëror, së bashku me çfarëdo detyre tjetër që mund t'i caktohet nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)/ Koordinatori Nacional për MIK dhe Menaxhmenti i Lartë i Autoriteteve të përfshira në MIK.

**Njësia e Përbashkët për Inteligjencë, Analizë të Rrezikut dhe Kërcënimeve (NJPIARK):** Nënkupton njësinë në kuadër të QKMK-së, e cila përdoret për identifikimin, mbledhjen, analizën e informacionit, vlerësimin e rrezikut dhe kërcënimeve dhe parimisht shpërndarjen e informatave, monitorimin dhe testimin, në mes të autoriteteve përgjegjëse në QKMK dhe po ashtu në mes të përfaqësuesve të autoriteteve përgjegjëse në PKK, si dhe njësitet dhe sektorët relevant në sferën e rrezikut, inteligjencës dhe hetuesisë, së bashku me çfarëdo detyre tjetër, që mund t'i caktohet nga MPB dhe Menaxhmenti i Lartë i Autoriteteve të përfshira në MIK.

**Ministria e Shëndetësisë**
MISIONI Ruajtja e shëndetit, promovimi i mënyrave të shëndetshme të jetesës dhe ofrimi i shërbimeve cilësore të sigurta, me qasje të lehtë, të barabartë, pa rrezik financiar dhe kosto-efektive
Vendos norma dhe standarde dhe nxjerr udhëzime për sektorin e shëndetësisë dhe mbrojtjen e mjedisit duke i respektuar standardet relevante ndërkombëtare; Mbikëqyr zbatimin e këtyre standardeve, duke përfshirë edhe inspektimin dhe shërbimet tjera sipas nevojës (përmes Inspektoratit Farmaceutik dhe Inspektoratit Shëndetësor), si dhe përcjell situatën e shëndetësisë dhe zbaton masat adekuate për të parandaluar dhe kontrolluar problemet në lëmin e shëndetësisë.

MSH përmes DSHB ofron programe dhe kujdes shëndetëso për perdorusit e narkotikëve brenda burgjeve në mënyrë të barabartë me shëndetin publik.

**Njësisa e Inteligjencës Financiare**
Si agjenci në kuadër të Ministrisë së Financave, NJIF është përgjegjës për kërkimin, marrjen, analizimin dhe shpërndarjen tek autoritet kompetente dhe bërjen publike të informacionit në lidhje me pastrimin potencial të parave dhe financimin e terrorizmit.

**Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë**
MASHT ka një rol të rëndësishëm në fushën e parandalimit dhe vetëdijesimit nëpërmjet hartimit të kurrikulave, organizimit të aktiviteteve vetëdijesuese në parandalimin e dukurive negative.

**Ministria e Punëve të Jashtme**
MPJ ka rol në drejtim të dhënies së ndihmës për bashkëpunim ndërkombëtarë në luftën kundër narkotikëve.

**Ministria e Integrimit Evropian**
MIE siguron që korniza ligjore dhe politikat qeveritare janë në harmoni me legjislacionin dhe politikat e BE-së.

**Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit**
Krijon politikat për kulturën, rininë, sportin dhe trashëgiminë kulturore. Harton programe për shqyrtimin e nevojave të të rinjve dhe përkrahjen e tyre, e në veçanti identifikimin dhe përkrahjen e grupeve specifike të rrezikuara. Krijon programe për ngritjen e nivelit të komunikimit kulturor dhe bashkëjetesës mes kulturave të të gjitha komuniteteve etnike, fetare apo gjuhësore në vend, duke përfshirë edhe promovimin kulturor dhe bashkëpunimin në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit.

**Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor**
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor merr pjesë në monitorimin e asgjësimit të mbeturinave nga bimët narkotike dhe substancat narkotike të konfiskuara, në bashkëpunim me institucionet kompetente.

## 6. Objektivat e Strategjisë kundër Narkotikëve

Kërcënimet nga narkotiket janë të vazhdueshme, andaj edhe parandalimi dhe luftimi i tij kërkon përkushtim dhe angazhim të vazhdueshëm, si dhe zhvillim të mëtejmë të kapaciteteve. Prandaj, përkundër faktit se Institucionet e Republikës së Kosovës kanë arritur rezultate të kënaqshme në fuqizimin e kapaciteteve, si dhe efikasitet në parandalimin dhe luftimin e narkotikeve, megjithatë konteksti aktual në Kosovë, si dhe trendi i zhvillimeve globale, nga të cilat mund të ndikohet edhe Republika e Kosovës, ngrit nevojën e domosdoshme për këtë dokument strategjik, me qëllim të parandalimit dhe luftimit efikas të narkotikeve.

Duke u bazuar në efikasitetin dhe rezultatet nga strategjitë paraprake, edhe më tutje, aktivitetet e Institucioneve të Republikës së Kosovës në parandalimin dhe luftimin e narkotikeve janë të orientuara në tri( 3) objektiva Strategjike :

1. **Objektivi Strategjik : REDUKTIMI I KËRKESËS DHE ZVOGËLIMI I DËMIT**
2. **Objektivi Strategjik : REDUKTIMI I OFERTËS DHE FURNIZIMIT**
3. **Objektivi Strategjik : BASHKËPUNIMI DHE KOORDINIMI**

### 6.1 Reduktimi i Kërkesës dhe Zvogëlimi i Dëmit

